

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konflikti për pagat e magjistratëve, BIRN: Një kapitull i ri i përplasjeve të Ramës me drejtësinë! Qëllim sh përqendrimi nga protestat
ADRESA	https://piranjat.al/politike/konflikti-per-pagat-e-magjistrateve-birn-nje-kapitull-i-ri-i-perplasjev-i104179
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:07:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:54:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5ef20eeeba2555cd9845ea5734c9b59c56ca7539d9bde646dfb43fd562cc6b59
TEKSTI	807483f8e77e95e666abfc3a4c5ecec89901a3fc1ddebd282410e92bdeb1d7d6
PAMJA	fcd153c7457274d7a755f8ec04548b3603547a5dcfcd2074b83f46af3f60f37

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f8479db8afcdef1d88c8f4fd0f68c4711a5a78b78b4f18ef282a68a414b348af
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9887a58f034e5892caf63e36ccbe81dcf86c1b224001923b84c66783530d965e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f8479db8afcdef1d88c8f4fd0f68c4711a5a78b78b4f18ef282a68a414b348af>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

perplasjeve te
Ramës me
drejtësinë!

perplasje të
re publike
mes
kryeministrit

■ **Avdylla dhe**
Altin
Morina

Morina,
Aldo
Avdyli,

■ **me burg te**
përjetshëm,
absurdi se si

gjatë per-
dy arratisje
spektakolare
nga burgjet

■ **sillen njerëz**
për ta
shkatërruar e

të
Shqipërisë,
duket se

■ **prapaskenat**
e kalimit të
Barcelona

[POLITIKË](#)

Konflikti për pagat e magistratëve, BIRN: Një kapitull i ri i përplasjeve të Ramës me drejtësinë! Qëllim shpërqendrimi nga protestat

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 09:54

LSAPHOTO.COM



Konflikti për pagat e magistratëve u shndërrua në një përplasje të re publike mes kryeministrit Edi Rama dhe drejtësisë, që sipas analistëve të politikës, ka për qëllim të shpërqendrojë vëmendjen dhe debatin publik nga protestat e përditshme.

Kryeministri Edi Rama e nisi javën me një sulm publik ndaj gjyqtarëve për çështjen e përllogaritjes së pagave të tyre, pasi mazhoranca që ai drejton zvarriti zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje.

"Historia e botës s'e ka parë që gjykatësit të thonë do t'i marrim paratë vetë nga thesari i shtetit se janë tonat dhe kjo "i kemi mbledhur vetë" është një hata më vete për nga shkalla rrëqethëse e paditursë mbi funksionimin e shtetit," shkruajti Rama në platformën X, duke komentuar një intervistë në media të kryetarit të Shoqatës së Gjyqtarëve, Engert Pëllumbi.

Gjyqtarët dhe prokurorët janë një target i preferuar për kryeministrin Edi Rama gjatë viteve të fundit, pavarësisht çështjeve të ndryshme me të cilat ai angazhohet në debat. Në konfliktin e fundit për pagat, kryeministri u përpoq ta devijonte debatin nga detyrimi për të zbatuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese tek pagat e larta të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.

Konflikti nisi pasi ministria e Financave dhe drejtoritë e Thesarit të Shtetit refuzuan të alokonin pagat për muajin gusht për të gjithë magistratët në sistemin e drejtësisë, sipas një përllogaritje të re për këto paga të bëra nga Këshillat bazuar mbi një vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Në retorikën e Kryeministrit, gjyqtarët shqiptarë paraqiten si një kategori e mbipaguar dhe rritja e mëtejshme e pagave do të përbënte një barrë për buxhetin e shtetit dhe tejkalimin me dhjetrafish të pagave në krahasim me sektorë të tjerë.

Por për analistët e politikës, kryeministri po e përdor këtë retorikë për të sulmuar organet e drejtësisë për arsye politike dhe po tenton të devijojë 'urrejtjen e publikut', që prej më shumë se 100 ditësh protesta është e fokusuar drejt qeverisë së tij.

Afrim Krasniqi nga Instituti i Studimeve Politika i tha BIRN se Kryeministri ka dy synime që nuk lidhen me zgjidhjen e problemit, por me agjenda paralele të tij.

Së pari - sinas tii ai kërkon ta nërdorë rastin nër nresion ndaj drejtësisë - në ka nxitur dhe një fushatë denionuese nga militantët dhe ndiekësit e tii

“Një tregues ky i rëndësishëm në kushtet kur SPAK do të duhet të marrë vendime lidhur me imunitetin e zv/kryeministres, me hetimet e Zvërnecit dhe dosjet e tjera VIP,” thotë Krasniqi.

Po ashtu, shton ai, “Rama kërkon ta zhvendosë vëmendjen e medias dhe publikut nga debati për skandalet dhe kritikën për keqqeverisje dhe korrupsion tek debati monolog kundër drejtësisë”.

Krasniqi e quan këtë një ‘debat monolog’, pasi kryeministri po ndan komente e shënime publike kundër një sistemi, i cili nuk i përgjigjet sepse është kolektiv, është diskret dhe vepron me akte ligjore.

Ndërsa Neritan Sejamina i konsideron sulmet e kryeministrit ndaj organeve të drejtësisë si një taktikë për të devijuar debatin dhe vëmendjen publike nga protestat e përditshme qytetare që kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit.

“Unë mendoj që është thjeshtë taktikë për të shpërqendruar vëmendjen nga problemet e tij dhe për të krijuar një shënjestër tjetër për të kanalizuar urrejtjen publike edhe diku tjetër përveç tij,” tha Sejamina.

Në muajin shkurt, Gjykata Kushtetuese konstatoi se formula e përdorur për llogaritjen e pagave të magistratëve kishte sjellë një “ulje të fshehtë” të pagës dhe urdhëroi Kuvendin të miratonte ndryshimet e nevojshme ligjore për përshtatjen e pagave me standardet kushtetuese. Gjykata përcaktoi si afat të fundit datën 31 korrik 2026, ndërsa efektet financiare duhej të shtriheshin që nga 1 prilli 2023. Megjithatë, deri në përfundimin e këtij afati Kuvendi nuk ndërmori ndryshimet e kërkuara, duke lënë të pagzjidhur edhe mënyrën e përlogaritjes së pagave nga 1 gushti e në vijim.

Në muajin gusht, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke interpretuar karakterin detyrues të vendimit, vendosën që të përcaktojnë pagat e gjyqtarëve sipas arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese me një pagë bazë referuese prej 222 mijë lekësh dhe 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin, si dhe kompensimin e rritjes së munguar që nga prilli 2023.

Në vend që konflikti të mbetej një çështje e zbatimit të një vendimi kushtetues, debati është shndërruar në një përplasje publike mes kryeministrit dhe gjyqësorit, pasi Ministria e Financave refuzoi të zbatonte formulën e pagave sipas vendimit të KLGJ-së duke sjellë si pasojë paditjen e ministrit dhe drejtorëve të Thesarit në gjykatë.

Sipas Krasniqit, kryeministri e shmang pikërisht thelbin e këtij problemi që lidhet me pyetjen se pse mazhoranca dhe Kuvendi nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

“Respektimi i këtij parimi dhe i detyrimeve kushtetuese do të kishte evituar krizën, debatin dhe koston e qytetarëve për shkak të tyre,” vlerëson Krasniqi.

Nga ana tjetër, Krasniqi vlerëson se KLGJ dhe KLP u nxituan në vendimarrjet e tyre, pa informuar publikun dhe pa ndjekur më parë instrumentet e tjera.

“Me të njëjtin pasion, shpejtësi e profesionalizëm që drejtësia mbrojtë e drejtat e veta kushtetuese në rastin e rrogave duhet të mbrojë edhe interesin publik kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë, pra të trajtojë rastet VIP dhe të dëshmojë se procesi i llogaridhënies, barazisë përpara ligjit dhe përballjes me pasojat e abuzimit e shkeljes së ligjit është i pakthyeshëm dhe i garantuar,” përfundoi ai./ BIRN

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 15 Shtator07:43

[**Dita e 108-të e protestës, kërkohet dorëheqja e Ramës dhe qeverisë së tij!**](#)

Protesta qytetare në Tiranë vijon edhe sot, duke shënuar ditën e 108-të të tubimeve të njëpasnjëshme. Protestuesi...

POLITIKE 14 Shtator22:52

[**Hetimet e SPAK/ Tomorri: Temperatura ka ndryshuar! Balluku s’është më e fuqishme si më parë**](#)

Gazetari i ekonomisë Klodian Tomorri e cilësoi çështjen e Belinda Ballukut si një nga hetimet me peshën më të madhe fi...

POLITIKE 14 Shtator22:41

[**Audiopërgjimi zbardh skemën/ Ron Yeffet: Do të përgatisim një letër zyrtare që të marrim informacione për gazin në Vlorë**](#)

Një tjetër audiopërgjim është publikuar mbrëmjen e sotme , ku del në pah se si Roni Yeffet drejton çdo institucion. Au...

POLITIKE 14 Shtator22:41

[**Rama çan me thonj pasagjerin, reagon Berisha: Dënoj me forcën më të madhe dhunën brutale të Padrinos**](#)

Lideri i opozitës shqiptare Sali Berisha ka reaguar me një shënim në faqen e tij në facebook pas publikimit të lajmit për dhu...

POLITIKE 14 Shtator22:32

[**“Nëse Veliaj del nga burgu, do të jetë rrezik për Ramën”/Analisti: Do të rikthehet më i fortë politikisht**](#)

Analisti Fitim Zekthi deklaroi nëse Erion Veliaj lirohet nga burgu, ai mund të rikthehet më i fortë në politikë dhe të pë...

POLITIKE 14 Shtator22:26

[**Përgjimi i Roni Yeffet/ Abilekaj: Flet për armë nga Sudani, kjo i heq licencën. Ku shkuan 30 mln euro?**](#)

Gazetari Enton Abilekaj ka ngritur pikëpyetje të forta mbi përmbajtjen e përgjimeve të Roni Yeffet, të publikuara nga ish-zëv...

POLITIKE 14 Shtator22:23

[**“Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat”, analisti Sulo ngre alarmin: Ç’po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s’i ka shpëtuar arrestit**](#)

Analisti Arion Sulo ngriti në “Top Story” pikëpyetje mbi standardin e ndjekur nga SPAK në rastin e Belinda Ballukut, duke e krahasuar...

POLITIKE 14 Shtator22:09

[**Hoxha: Balluku shkoi vetë te Delvina Gas me gjithë kupolën e institucioneve dhe udhëhoqi aksionin e bllokimit**](#)

Gazetari Artan Hoxha ka hedhur akuza të forta ndaj ish-ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, lidhur me atë ndë...

POLITIKE 14 Shtator22:07

[“Ministrinë e Energjisë ma lini mua!”, Bardhi reagon pas përgjimeve të reja të Ron Yeffet: Kush e drejton realisht shtetin shqiptar?](#)

Kreu i grupit parlamentar i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar pas publikimit të përgjimeve të reja të biznesmenit izraeli...

POLITIKE 14 Shtator22:01

[Delvina Gas/ Yeffet instruktin ukrainasit dhe rusët: Shkoni në Vlorë dhe thoni se përfaqësoni një kompani amerikane](#)

Audiopërgjimi i publikuar mbrëmjen e sotme në ‘Çim Peka LIVE’ në SYRI TV, ka zbuluar skandalet e reja të qeveris&eum...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eum...

POLITIKE 14 Shtator

[“Rama u tmerrua në sarajet e Surrelit” – Berish...](#)


Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka zhvilluar një konferencë për mediat pas rikthimit nga vizita e tij në Shtetet e Bashkuar...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video




Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.